

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE TIRANË

Raporti i Auditimit mbi përputhshmërinë të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë, me objekt “Mbi veprimtarinë ekonomike e financiare të DPT dhe procedurat e ndjekura në zbatim të legjislacionit tatimor”, për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2013 dhe konkluzionet përkatëse, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 102, nr.prot. 432/12, datë 6.8.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000 dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 4100.149.b), të INTOSAI, Pranuar dhe Sanksionuar në Rregulloren e Brendshme të KLSH, dhe strukturuar në “Udhëzuesin për Auditimin e Përputhshmërisë”, botim i KLSH, 2013, Kreu II, Pika 9, 149 b), II, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Vendimi i Kryetarit të KLSH-së Nr. 432/12, dt. 6.8.2014, u janë dërguar përkatësisht me shkresën nr. 432/13, datë 07.08.2014 Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Ministrit të Financave, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, Tiranë; me shkresën nr. 432/14, datë 03.9.2014, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Ekonomisë pranë Kuvendit, përkatësisht Kryetarit, Nënkryetarit dhe Sekretarit si dhe me shkresën nr. 432/15, datë 11.9.2014, me Vendimin dhe një përmbledhje të Raportit të Auditimit, janë njohur DG Enlargement Bruksel, Delegacioni i BE në Tiranë dhe SIGMA.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 432/12, dt. 6.8.2014 ka vendosur të miratoj Raportin e Auditimit mbështetur në standardet ndërkombëtare të auditimit ISSAI 4100.149.b), të INTOSAI, Pranuar dhe Sanksionuar në Rregulloren e Brendshme të KLSH, dhe strukturuar në “Udhëzuesin për Auditimin e Përputhshmërisë”, botim i KLSH, 2013, Kreu II, Pika 9, 149 b), II dhe mosdhënien e një opinionit të kualifikuar, nga ana e KLSH, në lidhje me përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2013, me kërkesat dhe kriteret e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kryesisht, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi, për shkak të pamundësisë për të arritur në konkluzione të sakta, të paraqitur në rezultatet e auditimit dhe përfundimin e Raportit të Auditimit, si pasojë e mosvënies në dispozicion nga Drejtuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar nga ana e KLSH, si më poshtë:

Auditimi u përqëndrua në realizimin e të ardhurave tatimore, zbatimin e legjislacionit tatimor dhe akteve administrative, në përputhshmërinë e veprimeve procedurale me përcaktimet ligjore e nënligjore, (kriteret dhe kërkesat e vlerësimit nga baza ligjore e përshkruar në program) kryesisht ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas drejtimeve të përcaktuara në Programin e Auditimit nr. 432/1, date 02.05.2014, ndryshuar me nr. 432/4, datë 13.6.2014, konkretisht mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit; mbi auditimin e pasqyrave financiare të institucionit për vitin 2013; mbi auditimin e pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeli; mbi auditimin e shpenzimeve për investime dhe prokurimet publike; mbi auditimin e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave tatimore; mbi detyrimet tatimore; mbi auditimin e sistemit të IT në lidhje me administrimin e të ardhurave dhe detyrimeve tatimore dhe auditimi i problemeve të tjera që mund të rezultojnë gjatë procesit të auditimit në terren.

Qëllimi i auditimit ishte vlerësimin objektiv, profesional e i pavarur i përputhshmërisë së veprimeve procedurale për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Shqipërisë, veprimeve administrative, ekonomike e financiare të DPT-së, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe me parimet e organizimit e të funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet përcaktimit dhe realizimit të objektivave të auditimit si më poshtë:

-Vlerësimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së DPT me ligjet tatimore dhe legjislacionin në fuqi në fushën e menaxhimit, të buxhetit, burimeve njerëzore e materiale për vitin 2013.

- Evidentimi i të metave dhe mangësive në lidhje me rregullshmërinë e procedurave sipas legjislacionit dhe rregullave të funksionimit të miratuara për DPT.
- Vlerësimi i realizimit të të ardhurave dhe administrimit të detyrimeve tatimore.
- Vlerësimi i transparencës me publikun dhe biznesin.
- Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës.
- Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, shlyerjen e dëmeve të mundshme ekonomike dhe parandalimin e mospërputhjeve në të ardhmen.

Një aspekt thelbësor në auditim ishte vlerësimi i shkallës së arritjes së objektivave të DPT por, nga auditimi, rezultoi që DPT nuk kishte përcaktuar objektiva për vitin 2013, përveç planit të të ardhurave që duhej të realizonte, të përcaktuar nga Ministria e Financave.

Me shkresën nr. 9788/3, datë 08.05.2014, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve i kthen përgjigje KLSH duke pranuar auditimin për disa drejtime të programit të auditimit dhe duke mos pranuar auditimin për sistemin e IT në lidhje me administrimin e të ardhurave dhe detyrimeve tatimore dhe auditimin e problemeve të tjera që mund të rezultojnë gjatë procesit të auditimit në terren.

Qëndrimi zyrtar i DPT në bazë të shkresës cituar më lart për të mos pranuar auditimin në mjetet që administrojnë detyrimet tatimore sipas programit të auditimit, kufizon në shkallë të gjerë qëllimin e auditimit për të konkluduar mbi përputhshmërinë e veprimitarisë së DPT me kërkesat dhe kriteret ligjore (Kreu I i Raportit) kryesisht ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” objekti i të cilit, neni 1, është: “Ky ligj rregullon procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Shqipërisë, si dhe parimet e organizimit e të funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë”. DPT duke mos pranuar auditimin në sistemin e administrimit të detyrimeve tatimore kufizon qëllimin e auditimit në 10 drejtori e sektorë nga rreth 16 gjithësej, ku funksionimi i tyre, mbështetet në të dhënat e sistemit të administrimit si Drejtoria e Apelimit Tatimor, Drejtoria e Investigimit të Brendshëm, Raportet e Auditit të Brendshëm, Drejtoria e Hetimit Tatimor, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Teknike, Drejtoria e Shërbimit dhe Regjistrimit të Taksapaguesve dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit.

Në këto kushte KLSH me shkresë nr. 432/3, datë 14.5.2014, protokolluar në DPT me nr. 9788/4, datë 14.5.2014 sjell në vëmendje të DPT se moslejimi i Grupit të Auditimit të KLSH për kryerjen e plotë të auditimit në zbatim të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH bie ndesh edhe me **Vendimin nr. 83, datë 29.10.2013 të Gjykatës së Apelit, Tiranë**, i cili në lidhje me nenet 24 dhe 25 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, shprehet si më poshtë:

“Neni 25 i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore”, në të pesë pikat e tij, rregullon vetëm veprimtarinë e nëpunësve dhe punonjësve të administratës tatimore, duke u përcaktuar atyre detyrimin e ruajtjes dhe përdorimit nga ana e tyre në mënyrën e duhur të “informacioneve që lidhen me tatimpaguesin” si dhe rastin kur ata mund ta shkëmbejnë këtë informacion me institucionet apo individët me të cilët ata kanë marrëveshje, dhe për rrjedhojë ky nen nuk ka të bëjë aspak me KLSH-në dhe të drejtën e këtij institucioni për të marrë informacionin e kërkuar nga subjektet e audituara.

Ruajtja e koinfidencialitetit nga ana e punonjësve të administratës tatimore, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 25 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore”, nuk nënkupton mosdhënien e këtij informacioni organeve të tjera shtetërore, në rastin konkret KLSH, të cilat kanë të përcaktuar me ligj detyrimin dhe të drejtën për shqyrtimin e këtij informacioni. “

“ Organet e administratës tatimore, nëpërmjet interpretimit të gabuar të këtij neni (neni 24), kanë vepruar në kundërshtim me përcaktimet e bëra nga ana e tij në lidhje me detyrimin që këto organe kanë në drejtim të dhënies së informacionit të kërkuar nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Sipas këtij neni, informacioni tatimor në lidhje me tatimpaguesit u ofrohet autoriteteve të përcaktuara në këtë nen (një ndër to është edhe KLSH) duke plotësuar dy kushte: të depozitojnë një kërkesë me shkrim

pranë organit të administratës tatimore që i administrojnë këto dokumente dhe të verifikohen rrethanat e përcaktuara në germën c, të këtij neni.

Referuar nenit 24 të sipërcituar, Kontrollit të Lartë të Shtetit i jepet “informacioni tatimor për tatimpaguesin”. Duke u shprehur në këtë mënyrë, ky nen i jep akses Kontrollit të Lartë të Shtetit në këtë informacion të tatimpaguesit, pavarësisht faktit se si mund të konsiderohet ai nga legjislacioni apo administrata tatimore si konfidencial apo jo konfidencial, pasi në vetvete ai është “Informacion tatimor për tatimpaguesin”.

Grupi i Auditimit gjatë vlerësimit të riskut konkludoi se moslejimi nga DPT i auditimit të dy drejtimeve më të rëndësishme, të programit të auditimit trajtuar më sipër, e kufizon në shkallë të gjerë auditimin deri në pamundësi të Grupit të Auditimit për të mbuluar fushat më me risk ku nga konkluzionet e auditimit në këto drejtime varet mundësia e grupit të auditimit për të konkluduar mbi përputhshmërinë e DPT me kërkesat dhe kriteret ligjore, (Kreu I i Raportit). Mospranimi nga DPT për auditim të plotë, sipas programit të auditimit dhe mbështetur në standardet e auditimit, diktoi nevojën për të kryer **një auditim të pjesshëm.**

Për të vlerësuar shkallën e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, Grupi i Auditimit kërkoi nga strukturat e DPT evidencë mbi politikën, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet për të adresuar risqet dhe për të dhënë garanci se objektivat e institucionit do të arrihen nëpërmjet veprimtarish efektive, eficientë dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme. Strukturat e DPT nuk paraqitën evidencë përse u kërkua më lart dhe në këto kushte Grupi i Auditimit vendosi të përdorë dy metoda auditimi, observim dhe intervistim, për të konkluduar mbi funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në DPT.

Duke qenë se mungonte vullneti për bashkëpunim nga DPT, Grupi i Auditimit u drejtua me kërkesë zyrtare duke kërkuar nga drejtuesit kryesor të departamenteve dhe drejtorive, përfshi zv/drejtorët e përgjithshëm, informacion dhe evidencë mbështetëse për mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të strukturës që drejtojnë, objektivat, prioritetet, regjistrin e riskut dhe kontrollet e instaluar për mbulimin e tij, rregullat e përcaktuara nga titullari i institucionit për garantimin e funksionimit të sistemit të MFK, strategjinë, strukturën dhe planet periodike të punës për realizimin e objektivave sipas strategjisë, regjistrin e procedurave dhe ndarjen e detyrave për çdo vend pune në strukturë.

Nga takimi i datës 3.6.2014, me drejtues të nivelit të lartë të institucionit, rezultoi se nuk njihej ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në këtë drejtim dhe mbikëqyrja dhe menaxhimi i punonjësve nën juridiksionin e tyre nuk ishte i strukturuar, monitorimi dhe kontrolli nuk ishin funksionale dhe të lidhura me realizimin e objektivave dhe komunikimi dhe raportimi nuk funksiononin qartësisht horizontalisht midis departamenteve dhe drejtorive por ishte i përqendruar vetëm vertikalisht.

Nga vlerësimi i përgjigjeve të administruara rezultoi se nuk ishte bërë prezent në asnjë rast dokumentacioni i kërkuar sipas ligjit, sa relatuar më sipër. Në të njëjtën kohë, Grupi i Auditimit, ndërmorri procedurën e intervistimit të strukturave në rang Përgjegjës Sektori dhe Specialisti.

Në 28 pyetësorë të shpërndarë, u plotësuan dhe u dorëzuan vetëm 9 prej tyre. Për pjesën tjetër u raportua nga specialistët që kishin marrë orientim nga eprorët të mos e plotësonin pyetësorin dhe për ata që e kishin plotësuar të mos e dorëzonin tek Grupi i Auditimit.

Nga vlerësimi i informacionit të përcjellë nëpërmjet pyetësorëve rezultoi që në rreth 50 % të të intervistuarve nuk njihej misioni i DPT dhe në pjesën tjetër që përgjigja ishte “Po” nuk dihej ku ishte i shkruar. Në lidhje me objektivat e strukturës ku bëjnë pjesë të gjitha përgjigjet ishin pozitive por në përkrahje të paktën një objektivi, edhe brenda një sektori nuk kishte të njëjtin objektivi të përkrahur dhe ato që ishin përkrahur ishin më tepër përafrim i gjykimit të të intervistuarit me qëllimin e ligjit për procedurat tatimore, nuk kishte asnjë lidhje me objektiva të përcaktuara, minimumi në rregulloren e brendshme të DPT. Në lidhje me aktivitetet e punës rreth 40 % e të intervistuarve raportuan që nuk i njihnin. Në lidhje me njohjen e risqeve të identifikuar rreth 70 % raportuan që janë njohur por që kjo nuk ishte reale pasi, në pyetjen tjetër që ka lidhje për identifikimin e pikave të dobëta në punën e të

intervistuarve, raportimi ishte 100 % për “Jo”. Në lidhje me pjesëmarrjen në trajnime rreth 70 % e të intervistuarve raportuan për “Jo”.

Në plotësim të detyrimit ligjor, raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të DPT, pyetëtori për vlerësimin e cilësisë së sistemit të MFK për vitin 2013 dhe plan veprimi për vitin 2014 janë dërguar Ministrisë së Financave me shkresë nr. 1985/3, datë 3.02.2014 por nuk është plotësuar deklaratë mbi cilësinë e sistemeve sipas kërkesave ligjore.

Nga verifikimi i trajnimeve të organizuara për vitin 2013 rezultoi se nuk ishin përfshirë trajnime për njohjen dhe implementimin e ligjit për MFK, manualit përkatës për implementim dhe akteve nënligjore përkatëse.

Nga vlerësimi i evidencës së grumbulluar për auditim dhe asaj nga procedurat e mësipërme rezultoi se ato ishin të pamjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore për të arritur në konkluzione të sakta dhe objektive mbi përputhshmërinë.

Në lidhje me auditimin e pagave, shpërblimeve dhe sigurimeve shoqërore, DPT është bërë pengesë për realizimin e programit të auditimit duke mos vënë në dispozicion të Grupit të Auditimit të KLSH evidencën e kërkuar për vlerësim të përputhshmërisë së veprimeve të DPT, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, neni 17 dhe ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Kreu I, pika 5, germa (ë) i VKM nr. 117, datë 5.3.2014 “Për mbajtjen, procedurën, dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”. Këto veprime për pengimin e KLSH për auditimin mbi zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës në DP të Tatimeve kanë bërë të pamundur arritjen e konkluzioneve të sakta dhe objektive mbi përputhshmërinë e veprimeve të DPT në procesin e vendimmarrjes për rekrutimin në punë të punonjësve, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe për masat disiplinore dhe administrative të aplikuara, me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; “Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë”; “Rregulloren e Brendshme të DPT”; Ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”; Ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Sa më sipër, DPT, duke mos vënë në dispozicion të auditimit evidencën e kërkuar për auditimin mbi përputhshmërinë në drejtim të marrëdhënieve të punës, kufizoi edhe më shumë qëllimin e auditimit edhe për drejtimin sipas programit të auditimit mbi pagat, shpërblimet, sigurimet shoqërore e të tjera personeli.

Me shkresë nr. 432/5, datë 13.6.2014 KLSH i drejtohet përsëri Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, për dijeni Ministrinë të Financave, për reflektim dhe krijimin e mundësive për të bërë të mundur realizimin e auditimit. Nga DPT përsëri nuk u vendos në dispozicion evidenca e kërkuar për auditim dhe në këto kushte Grupi i Auditimit adresoi një kërkesë zyrtare, drejtuar Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtorit të Përgjithshëm, për kërkesat e mësipërme, e protokolluar në DPT me nr. 9788, datë 17.06.2014. Në përgjigje të kërkesës së mësipërme, DPT me shkresë nr. 9788/68, datë 19.06.2014 përsëri nuk pranoi të vinte në dispozicion të auditimit evidencë nga dosjet e personelit për të cilat ishte bërë në vazhdimësi kërkesa e Grupit të Auditimit për qëllime auditimi.

Në bazë të veprimeve në vazhdimësi për mos vënie në dispozicion të Grupit të Auditimit të dokumentacionit të kërkuar, edhe pas shtyrjes së afatit të auditimit, KLSH i adreson DPT shqetësimin me nr. 432/7, datë 26.6.2014, për pengimin e qëllimshëm të auditimit nga DPT, duke argumentuar pse pengesat në vazhdimësi janë të qëllimshme dhe në vijim të veprimeve të qëllimshme nga administrata e mëparshme, përjekjet e KLSH brenda kuadrit ligjor e institucional, duke argumentuar të drejtat dhe detyrimet ligjore të KLSH si dhe duke bërë të ditur që DPT jo vetëm ka shkaktuar dështimin e plotë të programit të auditimit por njëkohësisht ka penguar KLSH në ushtrimin e detyrës funksionale audituese e cila demonstron fare qartë në shkresat dhe vendimmarrjen e Titullarit të DPT.

Në lidhje me auditimin mbi shpenzimet për investime dhe prokurimet publike, pasqyrat financiare, realizimi i të ardhurave dhe detyrimet tatimore, u paraqit informacion i përgatitur nga DPT por për shkak të kufizimit në shkallë të gjerë të auditimit, kryesisht duke mos vënë në dispozicion evidencën nga ku buron informacioni i mësipërm si dhe moslejimin për auditim nëpërmjet mjeteve të administrimit të informacionit, dosjet e subjekteve dhe programi software i IT i administrimit të të ardhurave dhe

detyrimeve tatimore, Grupi i Auditimit e kishte të pamundur të jepte konkluzione mbi saktësinë e tyre dhe përputhshmërinë me kërkesat dhe kriteret ligjore .

Sa relatuar në Raportin e Auditimit rezultoi:

a) Mbështetur në punën e kryer nga Grupi i Auditimit gjatë ushtrimit të auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të përshkruar në Kreun II të Raportit, nga 8 drejtime kryesore të auditimit të planifikuara, u grumbullua evidencë për auditim vetëm për 40 % të tyre, në formën e informacionit të përgatitur nga strukturat e DPT.

b) Nga evidenca e grumbulluar në formën e informacionit të përgatitur nga DPT, për shkak të kufizimeve të auditimit të përshkruar e nënvizuar në raport, ishte e pamundur për Grupin e Auditimit të krijonte bindjen mbi vlerësimin e përputhshmërisë së informacionit të raportuar me burimet e tij.

c) Nga auditimi rezultoi se evidenca e grumbulluar për qëllim të auditimit ishte e pamjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore për të arritur në konkluzione të sakta mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së DPT për vitin 2013, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi, Kreu I, i Raportit.

d) Objektivat e auditimit nuk u realizuan për shkak të pengesave të DPT për vënien në dispozicion të auditimit të evidencës së plotë të kërkuar për qëllim të auditimit, duke bërë të pamundur realizimin e qëllimit të auditimit.

Si rrjedhojë, mbështetur në standardet ndërkombëtare të auditimit ISSAI 4100.149.b) të INTOSAI, mbështetur në punën e kryer nga Grupi i Auditimit (Kreu II i Raportit) dhe rezultatet e auditimit (Kreu III i Raportit), për arsye të kufizimit në shkallë të gjerë të qëllimit të auditimit në bazë të argumenteve të përshkruara në (Kreun II të Raportit) dhe të nënvizuara në Raportin e Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit e kishte të pamundur të shprehë një konkluzion mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2013, me kërkesat dhe kriteret e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kryesisht, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi (Kreu I i Raportit).

Si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të mësipërme të DPT-së, KLSH e ka të pamundur të konfirmojë konkluzionet e Ministrisë Financave dhe Këshillit të Ministrave në VKM nr. 448, datë 09.07.2014 “Për propozimin e projektligjit “Për miratimin e buxhetit faktik të shtetit të vitit 2013”, por me qëllim që të mos bllokojë miratimin e buxhetit faktik 2013, KLSH në përmbushje të detyrimeve kushtetuese, do të paraqesë raportin për zbatimin e buxhetit faktik duke theksuar mosdhënien e opinionit të kualifikuar në lidhje me Administratën Tatimore për vitin 2013 si dhe bazuar në standardet ISSAI 1610 “Auditimi i jashtëm përdor punën e auditimit të brendshëm” dhe në Marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave, nënshkruar më 08.05.2012, në Raportin e Auditimit u përfshinë pjesë nga raportet e auditimit të kryer nga auditimi i brendshëm i Ministrisë Financave në DPT.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Albert Thoma p/grupi, Edvin Stefani, Vladimir Rizvani, Hekuran Avdulaj dhe Taulant Stërmasi, më tej u shqyrtua nga Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm zj. Luljeta Nano.

KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT